

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Auditim i sigurisë kibernetike mbi CGM, OPC/STA dhe EAS të ENTSO-E”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

72800000-8 – Auditim kompjuterik dhe shërbimet e testimit.

VLERA E FONDIT LIMIT:

1,350,000 (një milion e treqind e pesëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **“Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 500,000 (pesëqind mijë) Leke.*

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e shërbimeve objekt procedure prokurimi, kerkohet qe OE ofertues te paraqese se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare per ta realizuar ate ne kohe dhe ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara. Per kete, OE ofertues duhet te kete disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me kete qellim, eshte argumentuar se vlere e xhiros së kërkuar te jete ne masen 500,000 (pesëqind mijë) Leke.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata te ngjashme ne nje vlere te pakten prej 270,000 (dyqind e shtatëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.*

Lidhur me kete pike:

Kur OE ka realizuar kontrata me nje ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlere, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 41/3 dhe 55/4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën afërsisht 20 % të vlerës së fondit limit.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e shërbimeve objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë 20 % të vlerës së fondit. Në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kualifikime dhe shërbime të ngjashme në Institucione publike që janë pjesë e infrastruktures kritike të përcaktuara nga legjislacioni shqiptar dhe AKCESK. Kjo e vertetuar me realizim kontrate ose fatura tatimore të firmosura nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Eksperienca në auditime të ngjashme dhe të përfshira në projekte të tilla, të operatorit ekonomik, rrit sigurinë e një shërbimi optimal. Rrit sigurinë që përballja me ENTSO-E do të jetë optimale dhe në përmbushje me udhëzimet e kërkesat e tyre. Fakti që OE ka marrë pjesë në projekte të tilla dhe për institucione që sipas ligjit shqiptar për sigurinë kibernetike janë të klasifikuara si kritike, jep përporsi. Ky kriter është bazuar në nenin 41, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.3 Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i akredituar nga enti i akreditimit shtetëror shqiptar, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si trupe certifikuese sipas standardit ISO 27001. Ky kriter duhet dëshmuar me certifikatë leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga ente akredituese ndërkombëtare të njohura në Republikën e Shqipërisë.

Argumentimi: Për shkak të rëndësisë së auditimit duhet që kompania të jetë e akredituar për auditime dhe certifikime për standardet ndërkombëtare. Vertetimi OE disponon një trupe certifikuese me kualifikimet dhe certifikimet e duhura për të kryer punën e një Auditori kryesor për standardin ISO 27001, jep siguri maksimale për realizimin e kontratës. Sistemet që kërkojnë impenjim dhe persona të kualifikuar maksimalisht, duke qënë se AK është tek Operatorët Kritike të Informacionit. Ky kriter është bazuar në nenin 44, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.4 *Operatorit Ekonomik te kete ne staf, per te pakten 3 muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates, te paktën 2 specialista auditues ISO 27001, dhe 1 specialist auditues ISO 9001. Specialistet auditues te kerkuar duhet te kene ekperience prej te pakten 3 vjet.*

Per te provuar kete pike, duhet te disponohen certifikatat kualifikimi si Lead Auditor ose Auditor, CV, kontrata pune dhe listepagesat per periudhen e kerkuar.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin si prove paraprake formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 10.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Numri i punonjësve të siguruar është vendosur në perputhje me volumin e shërbimit si dhe afatin e ekzekutimit të kontratës dhe ky numër punonjësish është i mjaftueshëm për realizimin në kohë dhe me sukses të saj. Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të kete garanci që ofertuesi do të realizojë shërbimin objekt prokurimi, në perputhje me specifikimet teknike. Ky kriter është bazuar në nenin 41, pika 4/b, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Auditimi kërkon persona të kualifikuar dhe me eksperiencë në fushën e standardizimit për sigurinë e informacionit. Një Auditor i mirë duhet të ketë kaluar një eksperiencë dhe të vertetojë që edhe di të implementojë këto kërkesa të standartit. Numri 2 i personave si konsulentë ISO 27001 është përcaktuar në bazë të udhëzimit të listës së kontrollit, dhe mendojmë që dy konsulentë të kualifikuar janë mjaftueshëm për të përbërur volumin e përcaktuar. Kemi menduar se numri i kërkuar përmbush disa cikle të implementimit të një standardi ISO.

2.3.5 *Ne funksion të plotësimit të Shtojcës 10 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emer, Mbiemër, Ates, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratoret e shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posaçëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.*

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetencë përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i ketyre personave kerkon te dhëna te sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Termat e Referencës jane hartuar duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per mallrat objekt procedure prokurimi, duke perlllogaritur sasite e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar.